



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 60/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në shenjat publike të trafikut, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 25.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, me datën 24.04.2012 në orën 22:55, në Ferizaj, gjatë fushatës zgjedhore në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Ferizajt, anëtarët e subjektit politik të LDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar të komunës së Ferizajt, Adem Salihaj, mbi shenjën publike të trafikut. Sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektin Politik, Rregulloren Zgjedhore Nr.11/2009, ku në nenin 3 (b) parashihen veprimet e ndaluara të subjekteve politike, e konkretisht është bërë shkelje e nenit 3-1 b të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike si dhe neni 33 (a) i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, të kandidatit për kryetar komunës në Ferizaj nga radhët e subjektit politik të LDK, Adem Salihaj.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK, më datë 26.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më

datë 27.04.2012, në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar.

Pasi që ankesës i ka munguar adresa se ku ka ndodhur shkelja e supozuar dhe fotografia e ofruar si provë nuk ka qenë bindëse. PZAP-i, më datë 26.04.2012 rreth orës 14:10 – 14:20, ka kontaktuar nëpërmes telefonit me numrin e theksuar në ankesë për kontakt nga i cili ka kërkuar që dëshmitë e ofruara të përsëritën dhe të specifikohet saktë se ku ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesën Anr. 60/2012. PZAP-i, më 27.04.2012 gjegjësisht në ora 11:05 nëpërmjet e-mail-it zyrtar ka pranuar përgjigje për plotësimin e ankesës Anr. 60/2012. Nga e-mailin e pranuar shihet se pala ankuese nuk ka mundur të siguroi adresën se ku ka ndodhur shkelja e supozuar dhe ka përsëritur më te ndriçuar foton që e kishte bashkangjitur paraprakisht ankesës si provë.

Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton se:
PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Neni 3 paragrafi 6 pika b dhe c, e Rregullave dhe Proceduarve të PZAP-it përcakton:

(b) një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarë do dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga fotografia e cila gjendet në shkresat e lëndës si provë në të cilën shihet se posterit i kandidatit për kryetarë komune të Ferizajt Adem Salihaj nga radhët e subjektit politik LDK, se është i vendosur në shenjën e trafikut ashtu siç ka potencuar parashtruesi i ankesës mirëpo kjo provë nuk është vlerësuar si e plotë nga shkakun se nuk i plotëson kushtet të cilat kërkojnë më nenin 3.6. pika b dhe c e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, që e njëjta të vlerësohet si provë sepse të njëjtës (fotografi) i mungon adresa e saktë se ku ka ndodhur shkelja e supozuar si

njëri ndër elementet kryesore të provës së plotë andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 60/2012 më datën 28.04.2012

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

